

RAPORT

**MBI VLERESIMIN E AFTESISE MBAJTESE
STRUKTUREORE TE OBJEKTIT EKZISTUES**

**“PALLATI NR. 8 DHE NR. 10 (5709, 5711)”,
RRUGA “PELIKANI”
BASHKIA DURRES**

Përgatitur nga ‘ARKON Studio’ sh.p.k.

ING. DHIMITER PAPA



Durres, 2021

ABSTRAKT

Studimi dhe raporti ne vijim ka per qellim te perfaqesoje Aktekspertizen e Thelluar sipas percaktimeve dhe konform Vendimit te Keshillit te Ministrave VKM Nr. 26 date 15.01.2020 "Per kryerjen e Aktekspertizes se Thelluar ne ndertesat e demtuara" nga termeti i dates 26.11.2019. Te gjitha percaktimet, analizat dhe vijueshmeria e procedures se meposhtme mbeshitet ne percaktimet e bazes ligjore sipas kesaj VKM. Ne kete analize kemi te bejme me nje objekt i cili do te studiohet nga ana strukturore me qellim vleresim e kushteve dhe gjendjes se godines krysisht ne lidhje me performancen dhe kapacitetin sizmik. Metodologjia perfshin prova in-situ (ne terren), teste laboratorike, studim gjeologo inxhinierik te sheshit te ndertimit dhe konsiderimin e parametrave gjeoteknike te shtresave dhe formacioneve perberese, studim sizmologo inxhinierik te sheshit te ndertimit dhe sizmicitetin e zones, aplikim te metodave analitike. Ngarkesat sizmike jane vleresuar duke u bazuar ne metoda bashkohore si edhe konceptet e perdorura me pare. Nje kontroll i imtesishem eshte realizuar nga grupi topografik ne lidhje me kontrollin e vertikalitetit te struktures pas termetit. Ky dokument paraqet nje procedure te mire ezauruar mbi vleresim e kapacitetit sizmik te struktures me konstruksion mbajtes me rama beton arme, ne rastin e eventeve sizmike te fuqishme. Analiza qe kryhet eshte gjith perfshirese, per ndertesen ne shkalle globale dhe per elementet e vecante ne nivel lokal me fokus ne zonat me predispozim me te larte ndaj humbjes se qendrueshmerise dhe shkaterrimit. Analiza e struktures ekzistuese kryhet nepermjet modelimit me Metoden e Elementeve te Fundem me programe te avancuara kompjuterike, metode e cila mundeson zgjidhje efektive dhe saktesi shume te larte duke perfshire sjelljen brenda dhe jashte planare te elementeve, per te arritur ne nje vleresim perfundimtar mbi mekanizmat e kolapsit lokal dhe global, si edhe performancen sizmike te struktures. Mbi bazen e rezultateve te analizes se mesiperme eshte arritur ne konkluzionet dhe rekomandimet e analizes se thelluar dhe eshte perpiluar projekti i nderhyrjes rehabilituese/ perforcuese. Projekti i nderhyrjes eshte hartuar mbi bazen e kushteve teknike ne fuqi per vendin tone si edhe atyre europiane EC - eurokodeve ne fuqi. Per te gjitha objektet qe i jane nenshtruar analizes se thelluar dhe ka patur mungese dokumentacioni teknik, eshte bere azhornimi dhe dokumentimi i plote gjeometrik dhe teknik in situ si procedure pararendese e Aktekspertizes se thelluar dhe Analizes strukturore te thelluar. Sipas matjeve dhe qyrjeve faktike, eshte bere detajimi gjeometrik, planimetrite e objektit, planet e strukturave dhe te dimensionimeve gjeometrike te elementeve strukturale. Grupi i specializuar ka kryer marrjen e kampioneve sipas porosise se konstruktoreve dhe provat laboratorike te materialeve perberese te struktures. Bazuar ne te dhenat e mesiperme, ne rezultatet e provave laboratorike, studimin gjeologjik, studimi sizmiologjik, eshte realizuar modeli matematikor analitik me elemente te fundem i struktures si dhe projekti simulues i themeleve.



Objekti ne Studim, Pallati Nr. 8 dhe Nr. 10, Rruga Pelikani, Bashkia Durres.

PERMBAJTJA/ PASQYRA

1. AKTEKSPERTIZA E THELLUAR

- a) Mbledhja e të gjithë dokumentacionit ligjor dhe teknik për objektin
 - i. Projekti arkitektonik
 - ii. Projekti konstruktiv
 - iii. Lejet e dhëna nga autoritetet përgjegjëse
 - iv. Studimi gjeologo-inxhinierik dhe dokumentacioni topografik të objektit
 - v. Studimi sizmik
 - vi. Procesverbalet e punimeve të maskuara
 - vii. Raporti i llogaritjes së strukturës
- b) Evidentimi i ndryshimeve gjeometrike në strukturën e objektit gjatë kohës së shfrytëzimit
- c) Përditësimi gjeometrik i strukturës
- d) Mbledhja e dokumentacionit të zbatimit
- e) Katalogimi i dëmtimeve në objekt
- f) Gjykimi inxhinierik në bazë të raportit të llogaritjes së strukturës, të dokumentacionit të zbatimit dhe të shkallës së dëmtimit
- g) Konkluzionet për origjinën dhe shkallën e dëmtimit të objektit dhe përcaktimit të nivelit të dëmtimit nga aktekspertizat e mëparshme

2. ANALIZA E THELLUAR

- a) Studimi i dokumentacionit gjeometrik dhe teknik të objektit pa dokumentacion teknik
- b) Studimi i strukturave sipas përcaktimeve të SSH EN 1998-3:2005:
 - i. Studimi gjeometrik
 - ii. Studimi i materialit
 - iii. Studimi i detajimeve
- c) Studimi i strukturave, që do të shoqërohet me kryerjen e testeve, me shkatërrim dhe pa shkatërrim, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin Europiane SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme me të
- d) Te dhena Gjeologjike dhe Sizmike
- e) Projekti stimulues bazuar në kushtet në fuqi
- f) Evidentimi dhe katalogimi i dëmtimeve
- g) Analiza lineare, sipas përcaktimeve të dhëna në standardin Europiane SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme me të, të përshtatshme për tipin e strukturës. Ngarkimi sizmik të bëhet sipas procedurës së përcaktuar në standardin Europiane SSH EN 1998-3:2005 ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme
- h) Analiza Jo lineare sipas përcaktimeve të dhëna në standardin shqiptar SSH EN 1998, për tipin e strukturës
- i) Konkluzioni për performancën e godinës, sipas metodologjisë bazuar në standardin shqiptar për sizmicitetin dhe ngarkimin sizmik, sipas kushteve teknike dhe procedurave, sipas përcaktimeve në specifikimet teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme me standardin shqiptar për sizmicitetin
- j) Rekomandime për ndërhyrjet strukturale të nevojshme për kthim të strukturës konform kushteve teknike dhe përshtatjen sipas standardeve shqiptare ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme
- k) Projekti i ndërhyrjeve rehabilituese/perforcuese, Detajet, Metodologjia, Preventivi

VLERËSIMI I GJENDJES AKTUALE TË STRUKTURES

HYRJE DHE PARIMET E PERGJITHSHME

Metodologjia e pergjithshme sipas rekomandimeve te shprehura ne Eurokodin 8/3, dokumentet FEMA dhe ATC bazohet mbi keto etapa:

- Mbledhja e te dhenave ekzistuese per strukturen, historiku, praktika e ndertimit dhe projektimit ne kohën kur eshte projektuar dhe realizuar objekti, tipologjia, klasifikimi, vleresimi paraprak si edhe mbledhja e të dhënave mbi kriteret e projektimit sizmik të ndërtesës (në kohën e projektimit të saj);
- Identifikimi i te dhenave gjeometrike karakteristike per strukturen dhe detajet perkatese (lloji dhe tipologjia e elementeve strukture, permasat karakteristike te elementeve te ndryshem konstruktiv, themelet, elementet vertikale, soletat, traret, arkitraret, koloncinat, brezat si edhe armimi i tyre, armatura gjatesore dhe ajo terthore).
- Identifikimi i karakteristikave te materialeve, nepermjet provave laboratorike, analizes se materialeve, etj.
- Mbledhja e të dhënave mbi dëmtimet strukture të tanishme ose të mëparshme (nëse ka), duke përfshirë riparimet e mundshme që janë kryer në kohë, historiku, gjendja aktuale
- Rivlerësimi i ngarkesave të ushtruara në rastet kur ndërtesa shërben për qëllime të ndryshme nga ato të parashikuara në kohën e projektimit duke konsideruar edhe klasën e rëndësisë se ndërteses. Vecanerisht jane vleresuar objektet me nderhyrje ne katet perdhe, dhe ndryshimi i destinacionit nga banim ne sherbime etj.
- Vleresimi strukturor nepermjet analizave lineare sipas kriterëve te Eurokodeve
- Vleresimi strukturor nepermjet analizave jolineare (pershire edhe vleresimin e tabanit/themeleve nese eshte e nevojshme)
- Vleresimi i kapacitetit te elementeve strukturor
- Projekti i nderhyrjeve rehabilituese dhe perforcuese
- Vleresime tekniko-ekonomike
- Perfundime dhe rekomandime


PARIMET E PERGJITHSHME

Nevoja për riaftësim strukturor

Arsyet kryesore të kryerjes së vlerësimit strukturor të ndërtesave ekzistuese janë:

- jetëgjatësia e projektimit të ndërtesave (mosha e tyre)
- vlerësimet e sotme të rrezikut sizmik;
- ndryshimet në kodet e projektimit nga koha e ndërtimit deri sot;
- dëmtimet e ndryshme që kanë pësuar ndërtesat ndër vite.
- nderhyrjet arkitektonike te pa planifikuara





Vendodhja e Objektivit

Objekti ndodhet ne rrugen "Pelikani", "Bashkia DURRES" gjeresi dhe gjatesi gjeografike 41.311524 N dhe 19.485247 E sikurse tregohet edhe ne pamjet e mesiperme.

Jetëgjatësia e projektimit të ndërtesave (mosha e tyre)

Nëse mbajmë parasysh kërkesat e kushteve të vjetra të projektimit, apo edhe ato të kushteve të sotme, jetëgjatësia e projektimit të ndërtesave me përdorim të gjerë nga publiku është 50 deri në 100 vite. Kjo jetëgjatësi përcaktohet si një periudhë kohore gjatë së cilës struktura është e aftë të kryejë funksionin e saj pa pasur nevojë për ndërhyrje strukturore të rëndësishme.

Vlerësimet e sotme të rrezikut sizmik

Harta e parë sizmike e Shqipërisë është përpiluar rreth viteve 1952. Që nga viti 1952, për shkak të pasurimit të vazhdueshëm me të dhëna, rreziku sizmik është vlerësuar gjithmonë në rritje. Këtu ka rëndësi të përmendet fakti që për ndërtesat që janë ndërtuar përpara vitit 1979, kushtet teknike kanë qenë të vjetra, por edhe harta e rajonizimit sizmik ka pasur vlera të ulëta të intensiteteve sizmike të tërmeteve të pritshëm. Punime të viteve të fundit (si p.sh. ai i UNDP Albania dhe ai i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë) tregojnë për rritje të mëtejshme të vlerave që përfaqësojnë rrezikun sizmik. Në mënyrë të përafërt, botimet e sotme e vlerësojnë rreth (0.25 - 0.278 * g) nxitimin referencë në truall të fortë në Durrës për një periode kthimi 475 vite.

Duke u nisur nga ky fakt objekti ne studim ka nevojë per vleresim strukturor.

Ndryshimet në kodet e projektimit

Në fushën e inxhinierisë civile dhe asaj të tërmeteve janë bërë zhvillime shumë të mëdha, që nga koha kur ndërtesat ekzistuese janë projektuar dhe zbatuar. Kushtet Teknike të Projektimit në fuqi në vendin tonë (KTP-78 dhe KTP-N.2-89) datojnë që prej vitit 1978, pra ato janë tashmë 42 dhe 31 vjeçare.

Megjithëse përmirësimi i fundit i KTP-78 i bërë në vitin 1989 (KTP-N.2-89) është një kod projektimi që pasqyron mirë kërkesat e kohës së tij, ai qëndron relativisht larg në shumë prej kërkesave bashkëkohore të projektimit sizmik. Rregullat që përmban KTP-N.2-89 janë më shtrënguese se ato të kushteve teknike të mëparshme, por Eurokodet strukturore, procesi për adoptimin e të cilëve ka nisur tashmë edhe për vendin tonë, shprehin kërkesa akoma më të mëdha për ndërtesat.

Në këto kushte, arrihet në përfundimin se ndërtesat që janë projektuar me kushte teknike që ofrojnë një siguri të kufizuar në krahasim me kushtet teknike në fuqi, e akoma më të reduktuar në krahasim me kërkesat bashkëkohore (p.sh. ato të Eurokodeve Strukturore) duhet detyrimisht ti nënshtrohen rivlerësimit strukturor.

Duke u nisur nga ky fakt objekti ne studim ka nevoje per vleresim strukturor.

Dëmtimet që kanë pësuar ndërtesat

Në ndërtesat ekzistuese vihen re dëmtime të ndryshme të zhvilluara ndër vite. Ato mund të kenë ndodhur nga tërmetet e mëparshëm, nga cedimi i themeleve, nga dëmtimet e ndryshme nga përdorimi etj. Për të saktësuar ndikimin e këtyre dëmtimeve në kapacitet dhe në reagimin e strukturave në situatë sizmike është i nevojshëm vlerësimi strukturor i këtyre ndërtesave.

Duke u nisur nga ky fakt objekti ne studim ka nevoje per vleresim strukturor.

Të dhëna, studime dhe prova laboratorike

Me qëllim kryerjen e një vlerësimi strukturor dhe dhënien e rekomandimeve për ndërhyrje të mundshme strukturore në ndërtesat ekzistuese nevojitet të mblidhen të dhënat e mëposhtme:

- **gjeometria dhe hollësitë strukturore;**

Gjeometria dhe hollësitë strukturore duhet të merren nga një kombinim midis të dhënave të paraqitura në projektet origjinale dhe vizitave në vend që do shërbejnë për verifikimin e përputhshmërisë me projektet origjinale. Për të gjitha ndërtesat, nevojitet të bëhen vizatime të sakta të gjendjes ekzistuese, të cilat evidentojnë ndryshimet e mundshme që mund të jenë bërë gjatë zbatimit dhe gjatë periudhës së gjatë të përdorimit të ndërtesave.

- **të dhënat mbi materialet;**

Ne kuader te kesaj akt-ekspertize te thelluar, jane kryer prova te detajuara laboratorike mbi materialet (nuk kemi nje dosje te zbatimit). Konsulenti do te kryeje vetem prova shtese gjate fillimit te punimeve (nese i shikon te arsyeshme). Grupi i specializuar per testet laboratorike, ka zbatuar nje program te detajuar dhe nje plan te qarte provash, konform Kushteve teknike ne fuqi, EC. Hartimi i planit të provave dhe sigurimi i tyre është detyrë e Konsulentit. Realizimi i provave është ndjekur ngushte nga konsulenti, ne te gjithë proceduren e realizimit te tyre ne ndertese. Pozicionet e marrjes se kampioneve te provave jane evidentuar qarte neper planimetri dhe altimetri, ne cdo kat si edhe ne fasaden e objektit ne katin perdhe. Rezultatet e provave jane evidentuar dhe pasqyruar qarte ne nje raport te detajuar te perpiluar nga laborator i specializuar dhe i licensuar.

- **të dhënat gjeologo-inxhinierike, hidrologjike dhe sizmike;**

Këto të dhëna duhet të ballafaqohen me studimet e vjetra (nëse ato gjenden) dhe të vihen në pah ndryshimet e mundshme në studimet e kryera në kohë të ndryshme. Nga kerkimet e kryera nuk jane gjetur te dhena per prova te meparshme gjeologjike apo studime te mirefillta sizmike. Ne keto kushte,

nga ana e konsulentit fillimisht nevojitet të përpilohet një plan provash laboratorike për përcaktimin e parametrave gjeoteknikë të nevojshëm për verifikimet strukturore. Veçanërisht në rastet kur ka cedim të themeleve, plani i provave gjeologo - inxhinierike duhet të jetë i zgjeruar. Nisur nga rëndësia e këtyre ndërtesave, nevojitet gjithashtu një studim sizmik ose vërtetim për kushtet sizmike të vendit ku ato janë ndërtuar.

Ne rastin tone kemi shfrytëzuar studime gjeologjike dhe studime sizmike, qe jane kryer ne kuader te kesaj ekspertize te thelluar, jo vetem prane sheshit te ndertimit por edhe ne zone, pasi ne shume raste ndertesat e demtuara ndodhen prane njera tjetres. Pozicionet dhe thellesia e shpimeve gjeoteknike (boreholes) eshte percaktuar ne nje detyre te qarte te projektimit nga konsulenti dhe eshte zbatuar me perpikmeri nga skuadra gjeologjike e angazhuar prane sheshit te ndertimit. Bazuar ne kete studim gjeologjik si edhe ne matjet e shpejtesive te valeve ne formacionet perberese, eshte perpiluar studimi sizmik per cdo objekt qe i eshte nenshtruar akt-ekspertizes se thelluar.

- **inspektimi i gjendjes ekzistuese;**

Përpara fillimit të vlerësimit të plotë strukturor, konsulenti ka hartuar një material teknik paraprak të bazuar në disa vizita dhe inspektime në vend. Këto vizita/inspektime kanë për qëllim evidentimin e mangësive të mundshme strukturore, deformimeve, çarjeve, demtimeve ne pergjithesi apo problemeve të tjera që mund të vëzhgohen në mënyrë të drejtpërdrejtë. Mbi kete baze realizohet katalogimi i plote dhe i detajuar i demtimeve, ilustruar me foto dhe pershkrimin e demtimeve si dhe analizen e natyres dhe shkakut te cdo rasti.

- **Historia e dëmtimeve nga tërmete të shkuar;**

Të dhënat lidhur me dëmtimet që kanë pësuar ndërtesat në ngjarje sizmike të ndodhura në të shkuarën dhe riparimet që mund të jenë bërë duhet të mblidhen dhe të analizohen për të gjykuar mbi historinë e reagimit sizmik të këtyre strukturave.

Konsulenti duhet të plotësojë mbledhjen e të dhënave për të arritur njohje të nivelit KL3 (njohje e plotë sipas EN 1998-3). Vetëm në rast se kjo nuk është e mundur (për shkak të mungesës së plotë të të dhënave), do lejohet një nivel njohjeje më i ulët i strukturës, shoqëruar me argumentet përkatëse në raportin strukturor.

Si domosdoshmeri per realizimin e kesaj akt-ekspertize te thelluar, jane kerkuar materialet teknike ekzistuese te ndertesës, si Projekti Arkitektonik, Projekti Konstruktiv, Lejet e dhëna nga Autoritetet Përgjegjëse, Studimi gjeologo-inxhinierik, Studimi sizmik, dokumentacioni topografik të objektit, Procesverbalet e punimeve të maskuara, Raporti i llogaritjes së strukturës, etj., dokumentacione keto ndihmese dhe plotesuese ne funksion te aktit te ekspertizes.

Nga kerkimi prane arkives qendrore te ndertimit, nuk kemi gjetur asnje material teknik si me siper ne lidhje me objektin, as projekte te ndertesave te ngjashme per nga forma e objektit, qe do ti nenshtrohet Akt-ekspertizes se Thelluar. Ne keto kushte, per qellimet e mesiperme jane realizuar matje faktike te detajuara ne ndertese, ne te gjitha katet dhe ne cdo apartament. Keshtu si pararendese e punes jane perpiluar planimetrite e detajuara te ndertesës ne fjale. Matjet e bera dhe planimetrite e perpiluara jane kontrolluar dhe jane rakorduar edhe me matjet topografike te realizuara gjithashtu ne kuader te kesaj aktekspertize. Duke krahasuar planimetrite e kateve te ndryshme dhe duke konsideruar ndertesën me kate tip, eshte gjykuar ne lidhje me ndryshimet e mundshme gjeometrike te realizuara ne ndertese gjate shfrytezimit te saj.




Ne vijim eshte kryer perditesimi gjeometrik i struktures duke marre ne konsiderate te gjitha ndryshimet e bera gjate shfrytezimit te objektit. Nuk jane gjetur dhe nuk ekzistojne dokumentacione te zbatimit te objektit, kapaciteteve te dokumentimit, nuk ka fare dokumentim fotografik, dhe as procesverbale. Ndertimi i struktures i eshte nenshtuar KTZ (Kusht Teknik Zbatimi) perkatese, te cilave iu jemi referuar edhe ne. Ne kete kuader mund te themi se nuk jane evidentuar materiale te zbatimit te struktures.

Katalogimi i demtimeve ne objekt eshte bere duke bere vleresimin e cdo demtimi, arsyet dhe shkaqet e lindjes se tij, duke vleresuar faktin nese keto demtime kane qene ekzistuese ne ndertese, nga termete te meparshme qe mund te kete perjetuar ndertesa apo jane shkaktuar nga termeti i fundit nentor 2019 dhe pasgoditjet e tij. Ne perfundim te kesaj faze, kemi kristalizuar dhe kemi dhene gjykimin inxhinierik ne bazë të fakteve te grumbulluara, vzhgimit te detajuar dhe të shkallës së dëmtimit. Ky gjykim eshte shoqeruar me konkluzionet për origjinën dhe shkallën e dëmtimit të objektit dhe përcaktimit të nivelit të dëmtimit nga aktet e konstatimit paraprak apo akt-ekspertizat e mëparshme, nese ka patur te tilla. Ne vijim tregohet projekti arkitektonik dhe ai strukturor te modeluara sipas matjeve faktike ne vend.


a) Dokumentacioni Gjeometrik dhe Teknik i Strukturës së Objektit

Objekti "PALLATI NR. 8 DHE NR. 10, RRUGA PELIKANI" perfaqeson 2 objekte te ndare nga njeri tjetri me 8, 9 dhe 10 kate mbi toke + 1 kate podrum, i pa rregullt ne vertikalitet dhe ne plan. Cdo objekt eshte i perbere nga dy seksione, ku secili seksion ka shkallen dhe ashensorin perkates. Objekti ku ndodhet seksioni 1 dhe 2 ka siperfaqe te podrumit rreth 1130 m² dhe me siperfaqe te katit perdhe rreth 1160m² dhe siperfaqe te katit tip rreth 550m² per secilin seksion. Objekti ku ndodhet seksioni 3 dhe 4 ka siperfaqe te podrumit rreth 1005 m², siperfaqe te katit perdhe rreth 993m² dhe siperfaqe te katit tip rreth 550 m² per seksionin 3 dhe rreth 360m² per seksion 4. Lartesia e podrumit per te dy objektet eshte rreth 2.80 m, lartesia e katit perdhe rreth 3.50m dhe lartesia e katit tip eshte rreth 3.06 m. Destinacioni kryesor eshte ai i banimit dhe i sherbimit kryesisht ne katin perdhe te tij.


- Planimetria e podrumit



- Planimetria e katit perdhe



- Planimetria e katit tip



b) Studimi i Strukturave sipas Përcaktimeve të SSH EN 1998-3:2005

i. Studimi Gjeometrik dhe Studimi i Detajimeve te Pjeses Strukture te Ndertesës

Struktura e objektit "PALLATI NR. 8 DHE NR. 10, RRUGA PELIKANI" është konceptuar dhe realizuar me konstruksion mbajtes me rama beton arme (EC8 Frame System), ku ngarkesa sizmike perballohet kryesisht nga muret, kolonat dhe traret. Objekti i jep prioritet te dy drejtimeve perpendikulare per garantimin e zhvendosjeve te lejuara nga veprimet e ngarkesave te jashme, kryesisht atyre sizmike. Elementet konstruktive duhet te jene llogaritur dhe dimensionuar nen veprimin e ngarkesave maksimale te mundshme sipas kombinimit te ngarkesave. Strukturat horizontale perfaqesohen nga elemente beton arme, soleta me traveta me trashesi 25 cm. Ne teresi, struktura e objektit perfaqesohet nga nje sistem i paster konstruktiv, ku themeli eshte realizuar me

pllake beton arme, elementet vertikale me kolona b/a dhe elementet horizontal nga trare beton arme dhe soletat me traveta.

Themeli: eshte realizuar me pllake beton arme.

Kolonat: jane realizuar b/a me seksione: $b \times h = 90 \times 40$ cm, $b \times h = 80 \times 40$ cm , $b \times h = 60 \times 40$, $b \times h = 55 \times 35$ cm etj.

Muratura ndarese: eshte realizuar me tulla te kuqe me bira (vetembajtese) me gjeresi 12 , 20 dhe 25 cm.

Traret: jane kryesisht me prerje terthore drejtkendeshe me permasa $b \times h = 30 \times 50$ cm dhe petashuqe me permasa kryesisht $b \times h = 60 \times 25$ cm, $b \times h = 80 \times 25$ cm.

Arkitraret e Dyerve dhe Dritareve: Arkitraret e kesaj ndertese, ne pergjithesi jane tipike per dyert dhe dritaret dhe jane te realizuara prej beton armeje, te derdhura ne vend. Arkitraret variojne ne seksione pergjithesisht te njejta me gjeresi sipas gjeresive te mureve ku ata mbeshteten, si 25 cm ose 12 cm dhe lartesi 20 cm. Armohen ne menyre gjatesore me armature celiku me diameter 10 mm ose 12 mm.

Soletat ose elementet siperfaqesore horizontale, jane realizuar prej beton arme me traveta. Soletat kane trashesi 25 cm dhe jane te mbeshtetura ne nje ose dy drejtime ne varesi te hapesires qe ato mbulojne.


ii. Studimi i Materialit Perberese

Materialet, qe jane perdorur per strukturën (betoni dhe çeliku) duhet të plotësojnë të gjitha kriteret e parashikuara në KTP si dhe ato të parashikuara në Eurocode.

I. Çeliku

Në elementët parësorë për armaturën e hekurit eshte perdorur celik i tipit S500.

Çelik S500, $f_{ys} = 50\ 000$ kN/m², $f_{us} = 60\ 000$ kN/m², $E = 21\ 000\ 000$ kN/m², $\gamma_s = 1.15$, $\epsilon_{sy} = 0.25\%$, $\epsilon_{su} \geq 0.10\%$



- Diagrama sforcim-deformim e çelikut S500

Armatura e Zakonshme

Klasa e Celikut te Zakonshem	S500
Rezistenca Karakteristike e Rrjedhshmerise	$f_{yk} = 500 \text{ MPa}$
Rezistenca Karakteristike e Shkaterimit	$f_{tk} = 600 \text{ MPa}$
Moduli i Elasticitetit	$E_s = 210\,000 \text{ MPa} = 210 \text{ GPa}$
Koeficienti i Sigurise Parcialte te Celikut	$\gamma_s = 1,15$
Rezistenca Llogaritese e Celikut	$f_{yd} = f_{yk} / \gamma_s = 435 \text{ MPa}$
Rezistenca Llogaritese e Celikut ne Prerje	$F_{ywd} = 500 \text{ MPa}$
Koeficienti i Puassonit	$\nu = 0.30$

CELIKU PER ARMIMIN E KONSTRUKSIONIT BETON ARME (STEEL FOR REBAR S500)

Characteristic tensile stress $f_{tk} = 600 \text{ MPa}$

Characteristic yield stress $f_{yk} = 500 \text{ MPa}$

Characteristic ratio tensile/yield $1.3 \leq (f_t/f_y)_k \leq 1.35$

Elastic Modulus $E = 210 \text{ Gpa}$, Elongation $\geq 12 \%$


I. Betoni

Ne perputhje me EC2, betoni i klasës C25/30 eshte perdorur per realizmin e elementeve te struktures.

Parametrat e betonit të pa-shtrënguar (C25/30)

Beton C25/30

$f_{ck} = 25 \text{ kN/cm}^2$, $f_{cd} = 14.16 \text{ kN/cm}^2$, $\gamma_c = 1.5$, $\epsilon_{cy} = 0.20\%$, $\epsilon_{cu} \geq 0.35\%$



Parametrat e betonit të pa-shtrënguar (C25/30) jepen ne tabelen e mëposhtme:

Klasa e Rezistences se Betonit	C25/30 MPa
Rezistenca Karakteristike Cilindrike	$f_{ck} = 25 \text{ MPa}$
Rezistenca Karakteristike Kubike	$R_{ck} = 25 \text{ MPa (} f_{ck}, \text{cube)}$
Rezistenca Mesatare ne Shtypje (28 ditore)	$f_{cm} = f_{ck} + 8 = 25 + 8 = 32 \text{ MPa}$
Rezistenca Mesatare ne Terheqje ($\leq C50/60$)	$f_{ctm} = 0,3 \cdot f_{cm}^{2/3} = 3.2 \text{ MPa}$
Rezistenca Karakteristike ne Terheqje	$f_{ctk(5\%)} = 0,7 \cdot f_{ctm} = 2.24 \text{ MPa}$
Rezistenca Karakteristike ne Terheqje	$f_{ctk(95\%)} = 1,3 \cdot f_{ctm} = 4.16 \text{ MPa}$
Moduli Sekant i Elasticitetit te Betonit	$E_{cm} = 22[(f_{cm})/10]^{0,3} = 31 \text{ GPa}$
Moduli i Elasticitetit (Vlera Llogaritese)	$E_{cd} = E_{cm} / \gamma_c = 31/1.2 = 25.8 \text{ GPa}$
Koeficientet e Sigurise Parciale te Betonit	$\gamma_c = 1,5 \quad \square\square = 0,85$
Rezistenca Llogaritese ne Shtypje (SLU)	$f_{cd} = \square \cdot f_{ck} / \gamma_c = 14.16 \text{ MPa}$
Rezistenca Llogaritese ne Terheqje (SLU)	$f_{ctd} = f_{ctk(5\%)} / \gamma_c = 1.59 \text{ MPa}$
Koeficienti i Puassonit	$\nu = 0.20$

BETON PER MBISTRUKTUREN

Strength class of concrete **C 25/30**

Maximum dimension of aggregate $D_{max} = 25 \text{ mm}$, Concrete cover 50 mm

Cubic strength at 28 days $f_{ck, cube} \geq 25 \text{ Mpa}$, Cylindrical strength at 28 days $f_{ck, cyl} \geq 30 \text{ Mpa}$

Strength at ULS $f_{cd} = 14.16 \text{ Mpa}$, Tensile strength at ULS $f_{ctd} = 1.59 \text{ Mpa}$

Elastic Modulus $E_c = 27 \text{ 000 Mpa}$

- Rezistencat

Rezistencat llogaritese (te projektimit) per betonin dhe celikun jane marre nga reduktimi i rezistencave karakteristike sipas klases se betonit (apo celikut) te perdorur me faktorin e sigurise perkates si me poshte:

Per betonin: $f_{cd} = f_{ck} / \gamma_c$
 $f_{c,wd} = f_{c,wk} / \gamma_c$
 Per celikun: $f_{yd} = f_{yk} / \gamma_s$
 $f_{y,wd} = f_{y,wk} / \gamma_s$

- Niveli i njohjes se objektit

Per kete strukture duke u bazuar ne analizat dhe testet e kryera sipas EN 1998-3:2005 3.3.1 kemi nivel te njohjes se objektit (knowledge level) **KL2**: Limited Knowledge, referuar gjeometrise se struktures, detajeve dhe materialeve te perdorura.

Ky nivel njohurie reflektohet kryesisht ne CF (confidence factor), i cili sipas EN 1998-3:2005 3.3.1 tabela 3.1 do te kete vleren $CF = 1.35$

Niveli i njohjes	Gjeometria	Detajet	Materialet	Analiza	CF

KL1	Nga vizatimet e përgjithshme të ndërtimit me rilevim pamor të pjesshëm (me kampione)	Projektim i simuluar në përputhje me praktikat e kohës dhe nga inspektimi i limituar <i>in-situ</i>	Vlera të pranuar në përputhje me standardet e kohës kur është ndërtuar dhe nga prova të limituara <i>in-situ</i>	LF-MRS	CF _{KL1}
KL2	ose nga rilevim i plotë	Nga vizatimet fillestare të paplota të ndërtimit me inspektim të limituar <i>in-situ</i> ose nga inspektimi i zgjeruar <i>in-situ</i>	Nga specifikimet e projektit origjinal me prova të limituara <i>in-situ</i> ose nga prova të zgjeruara <i>in-situ</i>	Të gjitha	CF _{KL2}
KL3		Nga vizatimet fillestare të detajuara të ndërtimit me inspektim të limituar <i>in-situ</i> ose nga rilevim gjithëpërfshirës <i>in-situ</i>	Nga raportet origjinale të provave shoqëruar me prova të limituara <i>in-situ</i> ose nga prova gjithëpërfshirëse <i>in-situ</i>	Të gjitha	CF _{KL3}

- c) Studimi i strukturave, që do të shoqërohet me kryerjen e testeve, me shkatërrim dhe pa shkatërrim, sipas përcaktimeve të dhëna në Standardin Shqiptar SSH EN 1998-3:2005, ose specifikimeve teknike dhe/ose standarde të tjera të barasvlefshme me të

Klasat e materialeve beton dhe celik, për efekt të modelimit strukturor, janë marrë nga: "Raport paraprak mbi studimin e cilësisë së materialeve në objektin "Pallati Nr.8 dhe Nr.10, Rruga Pelikani" realizuar nga laboratori "ALTEA & GEOSTUDIO 2000".

Rezultatet për keto kampione janë përmbledhur në tabelen e mëposhtme si dhe në certifikatat bashkëngjitur.



LABORATORY TESTING for CONSTRUCTION MATERIALS
& GEOTECHNICAL STUDY
LABORATOR per KRYERJEN E PROVAVE TE MATERIALEVE TE NDERITMIT
& STUDIMEVE GJEOTEKNIKE

TEST REPORT RAPORT ANALIZE

PURCHASER / POROSITESI

"BASHKIA DURRES "

Address (Adresa) :

DURRES ALBANIA

RECORD N° RREGJISTRIM Nr		
ORDER N° POROSI Nr		
SITE KANTIERI	Hartimi i Projekteve te Nderhyrjeve Rehabilituese – Pershtatose te Nevojshme	
TEST / PROVA & TEST METHOD / METODIKA E PROVES	<p>TESTING CONCRETE IN STRUCTURES; UNDESTRUCTIVE METHOD: SCHMIDT HAMMER TEST / TESTIMI I BETONIT NE STRUKTURA; PERCAKTIMI I REZISTENCES NE SHTYPJE ME SKLEROMETER</p> <p>UNDESTRUCTIVE METHOD: DETERMINATION OF A DYNAMIC HARDNESS OF METALLIC MATERIALS / METODA PA SHKATERRIM : PERCAKTIMI I FOTESISE DINAMIKE NE ELEMENTET METALIK TE STRUKTURAVE</p>	<p>SSH EN 12504- 2:2012</p> <p>ISO 10859-1:2015</p>
SAMPLE KAMPIONI	Elemente Strukturore te Godines Building Structural Elements	NR. 5709, Pallati Nr.8, 10 kat + podrum, Rruga "Pelikan", Nderesa nr.8, Durres
SECTOR SEKTORI	MATERIALS MATERIALE	CONCRETE BETON
ENCLOSURE FAQET	4	
LABORATORY MANAGER PERGJEGJESI I LABORATORIT	ENG. KOZETA SHEPERI	
TECHNICAL MANAGER DREJTUES TEKNIK	ENG. SKENDER ALLKJA	

All Rights Reserved / Te drejta te Rezervuara

No part of this document may be reproduced in any way without the prior permission in writing of ALTEA & GEOSTUDIO 2000
Ndalohet riprodhimi dhe shpirtfshimi i ketyr dokumentit pa lejen me shkrim te laboratorit ALTEA & GEOSTUDIO 2000

Adresa: Autostada Tirane-Durres km 12, Pista 4/6
Korbanik, Tel: +355 4 4303 804; +355 4 4500 061
Mob: +355 682074332; Mob: +355 68 2031 906; Mob: +355 804071577
E-mail: altea@altea-geostudio.com
Website: www.altea-geostudio.com

TUV
AUSTRIA
HELLAS
EN ISO 9001 PMS
2007:2011
EN ISO 14001:2005
OHSAS 18001:2007
PMS 932312

ALTEA & GEOSTUDIO 2000
Assistance Laboratory
Technology Laboratory
TIRANE



IT 067 21 03 17



LABORATORY TESTING for CONSTRUCTION MATERIALS
& GEOTECHNICAL STUDY
LABORATOR PËR KRYENJEN E PROVAVE TE MATERIALIVE TE NGERTIMIT
& STUDIMEVE GJEOTEKNIKE



Page / Faqe Nr 1

Purchaser / Porositësi "Bashkia Durrës"

Adress / Adresa: DURRES

Site / Kamfieri Hartimi i Projekteve te Nderhyrjeve Rehabilituese – Pershtatese te Nevojshme

Objekti: NR. 5709, Pallati Nr.8, 10 kat + podrame, Rruga "Pelikan", Ndertesa nr.8, Durrës

Instrument Used/ Instrumenti i Përdorur: Silver Schmidt

Testimi i Testimit: **NR. 5709, Pallati Nr.8, 10 kat + podrame, Rruga "Pelikan", Ndertesa nr.8, Durrës.**
 Testing Concrete in Structures; Destructive Method; Schmidt Hammer Test/
 Testimi i Betonit ne Struktura; Percaktimi i Rezistences ne Shtypje me Sklerometer SSH EN 12504-2:2012

Rezultati:

Podioni i Testimit: **NR. 5709, Pallati Nr.8, 10 kat + podrame, Rruga "Pelikan", Ndertesa nr.8, Durrës.**

Name	Mean value	Averaging mode	Valid/Total	Std dev.	Conv. curve	Form factor
Podioni 1, Kollona K-1 Kati Perdhe	5.5 N/mm ²	Median EN	11/11	5.5 N/mm ²	10-percentile curve	Cube 150mm (100%)
Podioni 2, Kollona K-2 Kati Perdhe	5.0 N/mm ²	Median EN	11/11	5.0 N/mm ²	10-percentile curve	Cube 150mm (100%)
Podioni 3, Kollona K-3 Kati Perdhe	2.8 N/mm ²	Median EN	11/11	2.8 N/mm ²	10-percentile curve	Cube 150mm (100%)
Podioni 4, Kollona K-4 Kati Perdhe	1.3 N/mm ²	Median EN	11/11	1.3 N/mm ²	10-percentile curve	Cube 150mm (100%)
Podioni 5, Kollona K-5 Kati Perdhe	2.3 N/mm ²	Median EN	11/11	2.3 N/mm ²	10-percentile curve	Cube 150mm (100%)
Podioni 6, Kollona K-6 Kati Perdhe	4.0 N/mm ²	Median EN	11/11	4.0 N/mm ²	10-percentile curve	Cube 150mm (100%)
Podioni 7, Kollona K-7 Kati Perdhe	5.5 N/mm ²	Median EN	11/11	5.5 N/mm ²	10-percentile curve	Cube 150mm (100%)

Te Drejta te Rezervuar!

Ndaloher kopjimi dhe riprodhimi i kesaj certificate me çdo lloj menyre, pa autorizimin e abonentit.
 Laboratori AL.TEA & GEOSTUDIO 2000.



Adresa: Alenxandër Tringajës nr.12, Pinar Vite
 Kontakt: Nr. +355 4432 864 / 264 4430 865
 Nr. +355 9821 5032 / 4432 864 / 264 4430 865
 E-mail: info@altea-geostudio.com
 Website: www.altea-geostudio.com

TUV
 AUSTRIA
 ALTEA & GEOSTUDIO
 LABORATORY
 CERTIFIED ACCORDING TO
 DIN EN ISO 9001:2015
 DNR-17891-2019-01-17-1000-16-000004
 DT 067 21 03 17



LABORATORY TESTING for CONSTRUCTION MATERIALS
& GEOTECHNICAL STUDY
LABORATOR per KRYERJEN E PROVAVE TE MATERIALEVE TE NDERTIMIT
& STUDIMEVE GJEOTEKNIKE

TEST REPORT RAPORT ANALIZE

PURCHASER / POROSITESI

"BASHKIA DURRES "

Address (Adresa) :

Durres ALBANIA

RECORD N° RREGJISTRIM Nr		
ORDER N° POROSI Nr		
SITE KANTIERI	Hartimi i Projekteve te Nderhyrjeve Rehabilituese – Pershtatese te Nevojshme	
TEST / PROVA	TESTING CONCRETE IN STRUCTURES - CORED SPECIMENS - TAKING, EXAMINING & TESTING IN COMPRESSION TESTIMI I BETONIT NE STRUKTURA - HARRROTATE BETONIT - MARRJA, EKZAMINIMI & TESTIMI NE SHTYPJJE	EN 12504-1:2002
TEST METHOD / METODIKA E PROVES	UNDESTRUCTIVE METHOD; SCHMIDT HAMMER TEST / TESTIMI I BETONIT NE STRUKTURA; PERCAKTIMI I REZISTENCES NE SHTYPJJE ME SKLEROMETER	SSII EN 12504-2:2012
	UNDESTRUCTIVE METHOD; DETERMINATION OF A DYNAMIC HARDNESS OF METALLIC MATERIALS / METODA PA SHKATERRIM ; PERCAKTIMI I FOTESISE DINAMIKE NE ELEMENTET METALIK TE STRUKTURAVE	ISO 16859-1:2015
SAMPLE KAMPIONI	Elemente Strukturore te Godines Building Structural Elements	NR. 5711, Pallati Nr.10, 10 kat + podrum, Rruga "Pelikan", Nderetosa nr.10, Durres
SECTOR SEKTORI	MATERIALS MATERIALE	CONCRETE BETON
ENCLOSURE FAQET	6	
LABORATORY MANAGER PERGJEGJESI I LABORATORIT	ENG. KOZETA SHEPERI	
TECHNICAL MANAGER DREJTUES TEKNIK	ENG.SKENDER ALLKJA	

All Rights Reserved / Te drejta te Rezervuara

No part of this document may be reproduced in all ways without the prior permission in writing of ALTEA & GEOSTUDIO 2000
Ndalohej riprodhimi dhe shpeshimi i ketij dokumenti pa lejen me shkrim te laboratorit ALTEA & GEOSTUDIO 2000.

Adresa: Autostrada Tirane-Durres km 12, Peshkopia
Korçë, Tel: +355 4 4520 584; +355 4 4520 685
Më: +355 982074332; Më: +355 68 2031 980; Më: +355 694071577
E-mail: albert@altea-geostudio.com
Website: www.altea-geostudio.com

TÜV
AUSTRIA
HELLAS
EN 12504-1:2012 No. 1214/038
EN 12504-2:2012 No. 20.408.1204/038
ISO 9001:2015 No. 24.476/038
EN 15189:2013 No. 2001/038
EN 15189:2013 No. 2001/038

DA
LT 067 21 03 17





LABORATORY TESTING IN CONSTRUCTION MATERIALS & GEOTECHNICAL STUDY
 LABORATORIUM PËR KRYERJEN E PROVAVE TE MATERIALIVE TE MBRITËRIT & STUDIMEVE GJEOTEKNIKE

Page / Faqe Nr.2

Purchaser / Porositësi

Address / Adresa:

Site / Kantiери

Objekti:

Instrument Used / Instrumenti i Përdorur:

"Bashkia Durres "

Durres

Hartimi i Projekteve te Nderhyrjeve Rehabilituese – Pershtatese te Nevojshme

NR. 5711, Pallati Nr.10, 10 kat + podrum, Rruga "Pelikan", Ndertesa nr.10, Durres

Silver Schmidt

Testing Concrete in Structures; Destructive Method; Schmidt Hammer Test /
 Testimi i Betonit ne Struktura; Percaktimi i Rezistences ne Shtypje me Sklerometer SSH EN 12504-2:2012

Rezultate:

Posidoni i Testimit: NR. 5711, Pallati Nr.10, 10 kat + podrum, Rruga "Pelikan", Ndertesa nr.10, Durres

Nome	Mean value	Averaging mode	Valid/Total	Std dev.	Conv. curve	Form factor
pozicioni 4, Kollona K-4 Kati Nertoke	55 N/mm ²	Median EN	11/11	5.5 N/mm ²	30-percentile curve	Cube 150mm (100%)
pozicioni 5, Kollona K-5 Kati Nertoke	70 N/mm ²	Median EN	11/11	7.0 N/mm ²	30-percentile curve	Cube 150mm (100%)
pozicioni 6, Kollona K-6 Kati Nertoke	63 N/mm ²	Median EN	11/11	6.3 N/mm ²	30-percentile curve	Cube 150mm (100%)
pozicioni 7, Kollona K-7 Kati Nertoke	70 N/mm ²	Median EN	11/11	7.0 N/mm ²	30-percentile curve	Cube 150mm (100%)
pozicioni 8, Kollona K-8 Kati Nertoke	43 N/mm ²	Median EN	11/11	4.3 N/mm ²	30-percentile curve	Cube 150mm (100%)
pozicioni 9, Kollona K-9 Kati Nertoke	45 N/mm ²	Median EN	11/11	4.5 N/mm ²	30-percentile curve	Cube 150mm (100%)





Te Drejta te Rezervuar!
 Ndalohet kopjimi dhe riprochimi i kesaj certificate me qdo lloj menyre, pa autorizimin me shkrim te
 Laboratorit A.L.T.E.A & GEOSTUDIO 2000.

AlteA Albania
 Korrumb, Nr. 335, 4100 001, +355 4100 005
 Mq: +355 022 74002, Mq: +355 022 73073, Mq: +355 022 73077
 E-mail: altea@altea.com
 Website: www.alteastudio.com

TUV
 DA
 ALTEA
 CERTIFIED
 ISO 9001:2015
 ISO 17025:2017
 DT 067 21 03 17



d) Te dhena Gjeologjike dhe Sizmike

Studimi Gjeologjor Inzhinierik

Studimi Gjeologjik i Detajuar jepet ne raport te vecante, bashkengjitur aktit te ekspertizes, ketu kemi marre dhe iu jemi referuar parametrave kryesore gjeoteknike, te domosdoshem per llogaritjen dhe kontrollin e struktures.

1. Ne sheshin e ndertimit takohen depozitimet e Kuarternarit (Q₄ dt+kt) qe perfaqesohen nga suargjila, argjila lymore dhe surera si dhe depozitimet Neogjenike qe perbehen nga argjilite, ranore, konglomerate.
2. Niveli i ujit nentokesor eshte (-2.00) m nga siperfaqja e tokes, por ne kohe me lageshti ngrihet deri ne thellesine (-0.50) m. Jane ujra te kripura, jane agresive karshi hekurit dhe betonit, prandaj rekomandojme te merren masa kunder veprimit negativ te ujit nentokesor.
- 18
3. Nga studimi i kryer rezulton se sheshi ku eshte ndertuar **"Pallati Nr.10, (N. 5711), me 10 kate dhe podrum"**, Rruga "Pelikan", Durres, eshte me kushte te veshtira gjeologjino-inzhinierike. Ky ka qene dhe njeri nder shkaqet qe termeti i dates 26/11/2019, e ka demtuar seriozisht kete godine.
4. Prezenca e depozitimeve te dobeta ne kete shesh ndertimi, si edhe nga lekundjet e termetit te dates 26/11/2019, kane beret e lengezohen pjeserisht disa nga shtresat nen **"Pallatin Nr.5709-5711"**, ne plazhin e Durresit te cilat kane sjelle dhe demtimin e pjeseshem te godines.



5. Referuar karakteristikave te shtresave qe jane prezente ne kete shesh ndertimi duhet te behet rillogaritja e struktures se godines nga nje konstruktor me experience. Duhet marre parasysh ne llogaritjet e godines prezenca e depozitimeve te dobeta.
6. Neqoftese do te ndertohej nje godine e re, ne rekomandojme qe te perdoren themele te kombinuara, pilota dhe mbi pilota nje pllake betoni.

Studimi Inxhiniero Sizmologjik

Mbeshtetur ne "STUDIM INXHINIERO-SIZMOLOGJIK TE SHESHIT KU ESHTË NDERTUAR "PALLATI NR.10, (N. 5711), ME 10 KATE DHE PODRUM", RRUGA "PELIKAN", DURRES, bazuar ne punimet "Sizmiciteti Sizmotektonika dhe Vleresimi i Riskut Sizmik ne Shqiperi" (me Autore Aliaj. etj. 2010), Raportin mbi Mikrozonimin Sizmik te Qytetit te Durresit (Koçiaj etj. 1988) publikuar nga Akademia e Shkencave e Shqiperise dhe ne studime te shumta Inxhiniero Sizmologjike te kryera ne qytetin e Durresit nga Instituti i Sizmologjise si edhe ne te dhenat e Studimit Gjeologjiko Inxhinierik, Per sheshin e ndertimit, jane percaktuar parametrat sizmike te nevojshem per llogaritjet e kontrollit te struktures. Inputi sizmik eshte marre ne baze te studimi sizmologjik. Studimi sizmologjik eshte hartuar per parametra sizmik te zones dhe perqasjet sipas vleresimeve te riskut probabilitar sizmik dhe hartave te PGA. Per analizat ne "software" jane perdorur spektrat e projektimit te nxjerre nga ky studim.






Figure. Harta e Akseleracionit Maksimal ne truall shkembor per probabilitet 10% / 50 vjet ose 475 vjet periode perseritje, llogaritur me relacionet e shuarjes Sadigh etj., 1997 dhe Spudich etj., 1999 (Aliaj etj., 2010).

Ne perfundim, duke studiuar rezultatet e Studimit Gjeologjiko Inxhinierik dhe atij Inxhiniero Sizmiologjik, për vleresimin e rrezikut sizmik me programin kompjuterik *SHAKE 2000* te sheshit te ndërtimit të Objektivit ne Durres, autoret kane arritur ne *perfundimet* e meposhtme:

1. Sheshi i ndertimit ne studim klasifikohet si truall i kategorise se II-te sipas KTP-N.2-89, truall i klases "D" sipas Eurokodit 8 (EC-8, 2003).
2. Parametrat kryesore te rrezikut sizmik te sheshit te ndertimit ne studim ne kushte trualli shkembor jane: per periudhe perseritje 475 vjet: shpejtimi maksimal $PGA = 0.268$ g, ndersa shpejtimi spektral ne perioden 0.2 sek $S_a(0.2 \text{ sek}) = 0.626$ g dhe per perioden 1.0 sek $S_a(1.0 \text{ sek}) = 0.183$ g.
3. Sipas Kodit Shqiptar te Projektimit KTP N.2 - 89 parametrat per sheshin konkret te ndertimit jane: intensitet 9 balle (MSK-64), truall i kategorise se II-te: $kE = 0.36$ g, $\beta(T) = 2.0$, dhe shpejtimi spektral maksimal : $S_a(T) = 0.36 \times 2.0 = 0.72$ g, $TC = 0.4$ sek, $TD = 1.23$ sek.
4. Sipas Eurokodit 8, spektri elastik i reagimit qe rezulton, eshte si me poshte:
Per probabilitet 10 % / 50 vjet per kategorine "D" te truallit sipas EC-8 rezultojne parametrat: $S = 1.15$ TB = 0.20 sek, $TC = 0.6$ sek, dhe $TD = 2.0$ sek.
5. Nje parameter i rendesishem per reagimin dinamik te truallit jane periodat e vibrimit te pakos se depozitimeve dherore te vendosura mbi shkembinjte rrenjesore.
Perioda e vibrimit te truallit sipas spektrit te reagimit te nxitimit spektal, nga llogaritjet me programin "SHAKE 2000", vihet re ne brezin e periodave $T_s = 0.08$ deri 0.7 sek.
Perioda predominuese e vibrimit te truallit ne sheshin e ndertimit sipas formule $TP = 4H/V$ eshte $TP = 4 \times 30 / 286 = 0.419$ sek.

e) Projekti Stimulus

- Principet e modelimit 3D




- *Marredhenia force-zhvendosje e cila perfaqeson kapacitetin e cernierave plastike te elementeve bazuar ne EC8*

Modeli matematikor perfaqeson nje idealizim te nje numri te caktuar elementesh si shell, frame, link, tendon dhe joint. Keto objekte brenda programeve perdoren per te perfaqesuar muret, soletat, kolonat, traret dhe objekte te tjere fizike. Sistemet konstruktive perfaqesohen nga nje rrjet tre dimensional. Sisteme reale teper komplekse mund te perfaqesohen me modele matematikore me te thjeshtuara. Duke perdorur metoden e llogaritjes me elemente te fundem merren rezultate shume te sakta ne lidhje me focat e jashtme dhe ato te brendshme. Rezultatet perfshijne edhe sjelljen ne perredhje ose ate


jashte planare. Zgjidhja e modelit tre dimensional mundeson nje perfshirje maksimale te kushteve reale ne te cilat punon objekti ne realitet.

Analiza mundeson studimin e veprimit te ngarkesave horizontale dhe vertikale mbi strukture. Programet ndjekin metoden e dekompozimit te ngarkesave ku ngarkesat e shperndara ne soleta dekompozohen automatikisht ne ngarkesa nyjore te cilat transmetohen ne nyjet e trareve dhe me pas kolonave duke u shkarkuar ne bazament. Programet automatikisht gjenerojne ngarkesat e eres dhe ato sizmike te cilat perputhen me kodet e projektimit. Modet e lekundjes 3 dimensionale, format, frekuencat dhe periodat e lekundjeve te lira vleresohen me metoden Eigenvector ose Ritzvector. Gjithshtu programet ne varesi te kodit te projektimit mund te marrin ne konsiderate ne analizat statike dhe dinamike edhe efektet e P-Delta te cilat sjellin sforcime suplementare.

Nepermjet ketyre programeve mund te behen analiza te tipit Response Spectrum, Time History ose Push Over. Metoda qe perdoret per vleresimin e kapacitetit strukturor te nderteses eshte ajo e analizës Push Over e cila eshte nje analize etipit Nonlinear Static. Ne kete analize te dhenat per veprimin sizmik merren duke i dhene strukture nge zhvendosje te njohur ne nje pike te caktuar. Kjo zhvendosje aplikohet ne menyre te njetrajtshme ku reagimi i strukture monitorohet ne menyre te vazhdueshme duke krijuar kurben e kapacitetit strukturor deri ne momentin e krijimit te cernierave plastike ne trare dhe kolona. Duke krahasuar rezultatet e zhvendosjeve te marra nga analiza Response Spectrum (veprimi sizmik dhe ngarkesat vertikale) dhe ajo Push Over (kapaciteti i strukture), behet vleresimi i gjendjes se nderteses dhe aftesise se saj per te perbushur kushtet e sigurise dhe sherbimit.




- *Materialet e perdorura per modelimin – jane ne perputhje me te dhenat e testeve laboratorike*




- Seksionet e perdorura per llogaritjet


Te gjithë elementet perberes te struktures perfaqesohen ne modelin 3D nepermjet objekteve te cileve u vendosen karakteristikat fiziko mekanike te elementeve reale. Kjo arrihet nepermjet te dhenave qe futen ne program te cilat jane paraqitur me poshte:



- Te dhenat e perdorura per Analizen sizmike Response Spectrum



- Ngarkesat qe Aplikohen ne Model



- Kombinimet e Ngarkesave

Gjate procesit te analizes te kesaj ndertese, eshte vendosur, qe struktura te rimodelohet me 2 programe te avancuara kompjuterike, programin llogarites **TEKLA STRUCTURAL DESIGNER 2019** dhe ne **ETABS ULTIMATE 2018** per qellimet e ketij studimi. Struktura eshte modeluar sipas tipologjise te nderteses ekzistuese.

Per llogaritjet statike dhe dinamike te struktures se objekteve jane perdorur programet **TEKLA STRUCTURAL DESIGNER 2019** dhe **ETABS 2018**. Struktura eshte modeluar ne 3D me ndihmen e



programeve te avancuara kompjuterike duke perdorur elementet "Frame" (per traret dhe kollonat b/a), ato "Shell" (per soletat dhe shkallet b/a) dhe "Wall" (per muret). Per themelet eshte perdorur si mbeshtetje koeficienti i Winklerit. Të gjitha parametrat e përdorura në kontrollin e elementeve te struktures janë të perfshira ne ("Eurocode"); projektimi strukturor eshte bazuar ne kodet e meposhtme:

- [0] EN 1990 Eurocode 0 – Eurocode Basis of structural design
- [1] EN 1991-1-1 Eurocode 1 – Action on structures: General Action
- [2] EN 1991-1-4 Eurocode 1 – Action on structures: Wind Actions
- [3] EN 1992-1-1 Eurocode 2 – Design of concrete structures: General Rules
- [4] EN 1994-1-1 Eurocode 4 – Design of composite steel and concrete structures: General Rules and rules for building
- [5] EN 1996-1-1 Eurocode 6 -- Design of masonry structures: General rules for reinforced and unreinforced masonry structures
- [6] EN 1998-1-1 Eurocode 8 – Design of structures for earthquake resistance
- [7] KTP-N.2-89 Earthquake Resistant Design Regulations, issued by: Seismic Center, Academy of Science of Albania, Department of Design, Ministry of Construction

Llogaritjet e kontrollit per efekt te ketij studimi, jane kryer me programet ETABS ULTIMATE 2018 dhe TEKLA STRUCTURAL DESIGNER. Ndertesa eshte modeluar duke u konceptuar si sistem me murature mbajtese. Modeli dinamik i zgjedhur eshte ai me masa dhe parametra te shperndara. Ngarkesat dhe kombinimi i tyre jane percaktuar sipas Eurocode 1, 2, 5,6, 8 dhe jane paraqitur ne menyre te permbledhur ne tabelen e meposhtme (ne modelet llogaritese jepen me hollesi ngarkesat, mbingarkesat dhe kombinimet e tyre). Ngarkesa nga pesha vetiake e elementeve strukturele beton arme llogariten automatikisht nga programi bazuar ne volumin e elementit si dhe peshen njesi te b/a 2500 kg/m^3 dhe 1800 kg/m^3 per muraturen. Gjate llogaritjes se objektit per qellimet e ketij studimi jane marre parasysh ngarkesat dhe kombinimet e tyre si me poshte.

Per vleresimin e struktures do te realizojme analizat e meposhtme:

1. Analiza lineare me spekter reagimi dhe faktor sjellje sipas sipas EC8
2. Analiza jolineare statike 3D me plasticitet te perqendruar
3. Analiza jolineare statike 3D me plasticitet te shperndare

Ne vazhdim jepen detajet per analizat dhe te dhenat e nevojshme per kryerjen e tyre.

TË DHËNAT HYRËSE TË NEVOJSHME

Informacioni për vlerësimin strukturor duhet të përfshijë pikat e mëposhtme.

- a) Identifikimin e sistemit strukturor dhe përputhshmërinë e tij me kriteret e rregullsisë të EN 1998-1: 2004. Të dhënat për ndryshimet e mundshme strukture qe nga koha e ndërtimit.
- b) Identifikimin e tipit të themeleve të ndërtesës.

- c) Identifikimin e kushteve të truallit sipas kategorizimit të bërë në EN 1998-1: 2004, 3.1.
- d) Informacion për përmasat e përgjithshme dhe vetitë e seksioneve tërthore të elementeve të ndërtesës si dhe vetitë mekanike dhe gjendja e materialeve përbërëse.
- e) Informacion rreth defekteve të identifikueshme të materialeve dhe detajimit të papërshtatshëm.
- f) Informacion mbi kriteret e projektimit sizmik që janë përdorur në projektimin fillestar, përfshirë vlerën e faktorit zvogëlues (faktorit q) të forcës sizmike, nëse është përdorur.
- g) Përshkrimin e përdorimit aktual dhe/ose të planifikuar të ndërtesës (duke identifikuar edhe klasën e rëndësisë së saj, siç përshkruhet në EN 1998-1: 2004, 4.2.5).
- h) Rivlerësimin e veprimeve që ushtrohen duke mbajtur parasysh përdorimin e ndërtesës.
- i) Informacion rreth tipit dhe shtrirjes së dëmtimeve strukturore në të kaluarën dhe të tashmen, nëse ka, përfshirë masat e mëparshme të riparimit.

Ngarkesat dhe kombinimet e tyre janë konform KTP-N2-89 dhe Eurocode.

a. Ngarkesat Statike - (te Normuara) Ngarkesat e perhershme (Dead Loads-DL)

